



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.10.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.2) të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 ,e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 17.10.2025, të parashtruar nga Operatori Ekonomik Ermal Sylaj B.I. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rehabilitimi i ujërave të zeza dhe atmosferik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7489-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-100-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Aprovohet si pjesërisht e bazuar** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik Ermal Sylaj B.I., e dt.17.10.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Rehabilitimi i ujërave të zeza dhe atmosferik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7489-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-100-521, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 13.10.2025, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë:13.10.2025;

3. Autoriteti Kontraktues, vendos që ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Ernal Sylaj B.L., me dt.17.10.2025, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rehabilitimi i ujërave të zeza dhe atmosferik”, Nr. i prokurimit- 632-25-7489-5-2-1, Nr. i brendshëm-632-25-100-521.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.10.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet e juaja janë pjesërisht të bazuara, prandaj Autoriteti kontraktues do ta kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankësë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimi të këtij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;